

# FLETËNOTIM

## Kuvendi i Republikës së Kosovës

### I – VI/2012

Prishtinë -korrik 2012

Ky projekt/aktivitet financohet nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP), i financuar nga Zyra Zviceranepër Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) që implementohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

## **PERSONELI**

Ismet KRYEZIU - DrejtorEkzekutiv

email: [ikryeziu@kdi-kosova.org](mailto:ikryeziu@kdi-kosova.org)

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratësdhefinancave

email: [vjollca@kdi-kosova.org](mailto:vjollca@kdi-kosova.org)

Leonora CIKAJ - Asistentepëradministratëdhefinanca

email: [lcikaj@kdi-kosova.org](mailto:lcikaj@kdi-kosova.org)

ArsimGjinovci - IT &Design

email: [agjinovci@kdi-kosova.org](mailto:agjinovci@kdi-kosova.org)

## **PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE**

### **PRAKTIKAT PARLAMENTARE**

Driton SELMANAJ - Menaxher i programit

email: [dselmanaj@kdi-kosova.org](mailto:dselmanaj@kdi-kosova.org)

Halil MATOSHI - Analist

email: [hmatoshi@kdi-kosova.org](mailto:hmatoshi@kdi-kosova.org)

Isuf ZEJNA - Analist

email: [izejna@kdi-kosova.org](mailto:izejna@kdi-kosova.org)

NevahirHazeri – Analist

email: [nhazeri@kdi-kosova.org](mailto:nhazeri@kdi-kosova.org)

Florije MEHMETI - Vëzhguese e Parlamentit

email: [fmehmeti@kdi-kosova.org](mailto:fmehmeti@kdi-kosova.org)

## **PROGRAMI: TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI**

Merita MUSTAFA - Menagjere e programit

email: [mmustafa@kdi-kosova.org](mailto:mmustafa@kdi-kosova.org)

Besnik RAMADANAJ - Koordinator i projektit

email: [bramadanaj@kdi-kosova.org](mailto:bramadanaj@kdi-kosova.org)

Kujtim BYTYQI – Hulumtues/Analist

email: [kbytyqi@kdi-kosova.org](mailto:kbytyqi@kdi-kosova.org)

Enis XHEMAILI – Hulumtues/Analist

email: [exhemaili@kdi-kosova.org](mailto:exhemaili@kdi-kosova.org)

Shqipe GJOCAJ – Hulumtuese/ Analiste

email: [shgjocaj@kdi-kosova.org](mailto:shgjocaj@kdi-kosova.org)

### **PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE**

#### **PJESËMARRJA QYTETARE**

Naim CAHANAJ - Koordinator

email: [ncahanaj@kdi-kosova.org](mailto:ncahanaj@kdi-kosova.org)

### **PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA**

Liridon SELMANI - Menaxher i programit

email: [lselmani@kdi-kosova.org](mailto:lselmani@kdi-kosova.org)

## Përmbajtja

Mbarëvjetja e punimve në seancat plenare.....	5
Mbikëqyrja Parlamentare.....	6
Komisionet Parlamentare.....	7
Mbledhjet e Komisioneve parlamentare.....	8
Dëgjimet Publike.....	9
Monitorimi i zbatimit të ligjeve.....	11
Plani Legjislativ për vitin 2012.....	12
Analiza Krahasuese e Deputetëve .....	14
Tabela Gjenerale.....	15

## ➤ Mbarëvjetja e punimve në seancat plenare

Sesioni pranveror i Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2012 filloi punimet me 20 janar duk e organizuar takimin e parë për këtë vit kalendarik.

Gjatë këtij sesiioni për periudhën janar-gershor 2012 Kuvendi i Kosovës ka realizuar 24seanca plenare, prej tyre 20ishin të rregullta, 2 të jashtëzakonshme dhe 2 solemne.

Për dallim ngalegjislaturat tjera, kjo e fundit sidomos gjatë këtij gjashtë mujoriështë karakterizuar me një gjuhë të ashpër parlamentare nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, gjuhë e cila rezultoi edhe më përleshje fizike mes deputetëve. Prandaj, KDI vlerëson se kjo gjuhë e debatit nuk përkon me parlamentarizmin dhe traditën demokratike. Ky degjenerim i debatit parlamentar në terror verbal është tregues i kulturës së sekretit sipas traditave më të pështira të sistemeve totalitare.

Puna e kësaj legjislature në këtë gjashtë-mujor po ashtu ka dëshmuar se Kuvendi gjithnjë e më tepër po bëhet më pak përfaqësues, duke injoruar kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit. Për këtë dëshmon fakti se vetëm brenda periudhës një javore të muajit prill, Kuvendi ka miratuar 4 projektligje të cilat ishin kontestuar fuqishëm nga shoqëria civile dhe qytetarët e Kosovës (Projektligjin për Banka, Institucionet mikro-financiare, dhe institucionet financiare jo bankare, Projekt-kodin Penal, Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe dhe Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit). Injorimi i kërkesave të qytetarëve dhe shoqërisë civile mbetet ndër shqetësimet kryesore për integritetin e institucionit më të lartë përfaqësues.

Kjo periudhe raportuese po ashtu nuk ka dëshmuar efikasitete të Kuvendit edhe sa i përket mbikëqyrjesparlamentare ndaj ekzekutivit. Mosrespektimi i akteve të Kuvendit nga qeveria e Kosovës duke e relativizuar rëndësinë e tyre me një interpretim se ato nuk janë të obligueshme dhe janë vetëm të karakterit fakultativ (këshillimor), në fakt nxjerr në pah zbehtësinë e rolit të Kuvendit të Kosovës dhe tendencën e ekzekutivit për relativizim të rëndësisë së këtij institucioni me qëllim që të mos i bëhet pengesë në realizimin e qëllimeve të caktuara politike.

Çështje tjetër që e ka karakterizuar këtë periudhë raportuese ka të bëjë me shkeljen e procedurave për miratimin e ligjeve. Kuvendi i Republikës së Kosovës me insistimin e qeverisë së Kosovës jo rrallëherë deri më tani kanë shkelur rregullat e procedimit të projektligjeve goftë duke i proceduar dhe miratuar në procedurë të përshpejtuar apo edhe duke mos i proceduar fare konform strategjisë legjislative të qeverisë dhe Programit të Punës së Kuvendit të Kosovës.

Rast eklatantështë procedimi i plotësim ndryshimit të Projekt- Kodit penal të Kosovës, ende pa hyrë fuqi. Po ashtu edhe rasti tjetër i evidentuar është kur qeveria e Kosovës nën pretekstin e përgatitjes së legjislacionit për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur, ka proceduar për në Kuvendin e Kosovës Projektligjin për plotësim ndryshimin e 21 ligjeve të cilat janë në fuqi në Kosovë. Tendencë e Qeverisë së Kosovës që me një projektligj të vetëm të amendamentohen 21 ligje tjera, është kundër praktikave juridike të ligjbërjes si dhe shkakton konfuzion dhe vështirësi tek qytetarët për mundësinë e qasjes në ligjet të cilat bëhen të plotfuqishme.

Gjithashtu kjo periudhë raportuese është identifikuar me një mungesë të madhe të deputetëve për të marrë pjesë në seanca plenare. Nëse marrim parasysh vetëm seancat plenare të majit 2012 nga transkriptet del se maksimumi i deputetëve që janë të pranishëm në seanca plenare është 71, pra 60 %, ose pak më shumë se gjysma. E në rastet më të shpeshta në seanca plenare janë 61 – 62 deputetë, aq sa mjaftojnë për ta kaluar ndonjë ligj apo rezolutë, kurse të tjerët ose nuk vijnë fare në seancat plenare ose bredhin e llafosin në hollin e Kuvendit ose në kafenetë e kryeqytetit. Edhe ata që janë të pranishëm mund të fokusohen tek lexojnë shtypin, mbushin fjalëkryqë apo bredhin nëpër objektin e Kuvendit të Kosovës.

### ➤ Mbikëqyrja Parlamentare

Roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj Qeverisë së Kosovës, me theks të veçantë përmes instrumentit demokratik të kontrollit parlamentar-interpelancave parlamentare në këtë gjashtëmujor është mjaft i zbehur.

Ndonëse as instrumenti tjetër i kontrollit parlamentar, përmes pyetjeve parlamentare nuk është inkurajues. Numri shumë i vogël i pyetjeve parlamentare, të parashtruara nga deputetët e kësaj legjislature si dhe injorimi i tyre nga kabineti qeveritar tregon se deputetët e kësaj legjislature nuk janë shembulli i mirë i kontrollit dhe balancimit mes pushteteve.

Madje pyetjet parlamentare ndonjëherë janë kot e ndonjëherë tingëllojnë vetëm si performansë siç ndodhi në Seancën e 1 dhe 2 marsit 2012, kur katër deputetë i bënë të njëjtën pyetje Kryeministrit, rreth takimeve të tij me atëherë Presidentin serb, Boris Tadiq.

Fakti se roli mbikëqyrës i Kuvendit ka devijuar dëshmon edhe rasti kur Kuvendi i Kosovës në seancën e datës 10.05.2012, ka miratuar Raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011. Ky dokument për habi nuk ka nxitur aspak interesimin e deputetëve të Kuvendit për debat! Raporti është miratuar, pas deklarimeve të shefave të grupeve parlamentare dhe diskutimit të vetëm një deputeti.

Rastet kur deputetët votojnë amendamentet me porosi siç ndodhi në seancën e 20 prillit 2012, kur po votoheshin amendamentet për Projektligjin për Hoqën e Madhe, apo rastet ku deputetët vetëm pas pesë minutash pas votimit pendohen se çka kanë votuar dhe kërkojnë që vota e tyre të tërhiqet, siç ndodhi në seancën e 10 majit kur u votua rekomandimi për kushtëzimin e vazhimit të dialogut me Serbinë me zbardhjen e fatit të të pagjeturve, s' mund të kuptohen ndryshe vetëm se Kuvendin e Kosovës kjo klasë politike e ka shndërruar në një institucion pa dinjitet, pa integritet dhe pa pushtet duke e rrezikuar edhe pozicionin e tij në sistemin politik institucional sado të brishtë tanimë të etabluar në Kosovë.

Mosrespektimi i akteve të Kuvendit nga qeveria e Kosovës duke e relativizuar rëndësinë e tyre me një interpretim se ato nuk janë të obligueshme dhe janë vetëm të karakterit rekomandues siç ishte rasti i miratimit të rekomandimeve në fund të interpelancës, ku është diskutuar për të pagjeturit dhe bisedimet që janë zhvilluar me Serbinë në Bruksel. Pastaj mos respektimi nga ana e qeverisë të obligimeve që dalin nga Rezoluta për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, ku në Pika 6 e kësaj Rezolutive është përcaktuar kërkesa që: I/e emëruari nga Kryeministri udhëheqës i delegacionit të Republikës së Kosovës për dialogun me Republikën e Serbisë do të informojë në baza të rregullta

Komisionin për Politikë të Jashtme dhe komisionet tjera përkatëse të Kuvendit të Kosovës dhe do të raportoj, edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës, gjë e cila ka një periudhë shumë të gjatë që nuk po ndodh fare. E tëra kjo nxjerr në pah tendencën e ekzekutivit për cenim të integritetit të Kuvendit dhe humbjen e fuqisë së këtij institucioni në sistemin politik të vendit.

Sëkëndejmi del se Kuvendi i Kosovës është shndërruar në poligon eksperimental të politikave qeveritare, duke e zbehur edhe më tepër rolin mbikëqyrës.

Ekzekutivi i vendit në shumë raste për të ushtruar ndikimin politik mbi Kuvendin, ka ushtruar madje edhe presione të natyrave të ndryshme mbi deputetët, si grupe parlamentare dhe veç e veç, si në rastin e amendamentimit të projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe projektligjin për Hogën e madhe.

Kjo dëshmon se Kuvendi ka rrëshqitur në një institucion i cili tani më, po heq dorë edhe nga ushtrimi i kompetencave kushtetuese që ka si institucioni më i lartë kontrollues dhe përfaqësues në vend.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), vlerëson se kjo legjislaturë e Kuvendit gjithnjë e më tepër po dëshmon që nuk është në nivelin e përgjegjësive që ka, dhe njëkohësisht performanca e saj po tregohet si më e dobëta që kur jeta parlamentare ka filluar të instalohet në Kosovë.

#### ➤ **Komisionet Parlamentare**

Si mekanizma çenësorë në kuadër të parlamenteve, Komisionet parlamentare, kryejnë funksione shumë të rëndësishme në procesin legjislativ, në kontrollin e pushtetit ekzekutiv si dhe në transparencën e qeverisjes dhe të proceseve tjera politike.

Funksionet e komisioneve bazën legale e kanë në aktin më të lartë juridik dhe politik të vendit – Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren e Kuvendit, duke shqyrtuar dhe amendamentuar projektligje, shqyrtuar raporte të Agjensioneve të Pavarura, duke ushtruar kontrollin parlamentar ndaj qeverisë, duket përgatitur rekomandime për vendimet përfundimtare të Kuvendit si dhe duke monitoruar zbatimin e ligjeve.

Kjo legjislaturë ka gjithsejtë 13 Komisione Parlamentare. Katër (4) nga të cilët janë të përhershme, nëntë (9) janë komisione funksionale si dhe është themeluar edhe një (1) nën-komision (Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës) i cili funksionon në kuadër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi i Kosovës vitin e kaluar po ashtu pat themeluar edhe dy komisione ad-hoc:

Komisionin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe

Komisionin për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

## ➤ Mbledhjet e Komisioneve parlamentare

Ritmi i takimeve dhe i punës së komisioneve parlamentare, varësisht prej natyrës së fushë-veprimtarisë që mbulojnë komisionet parlamentare, në periudhën janar-qershor 2012, ka pësuar rënie për 2 mbledhje në krahasim me angazhimin e Kuvendit të Kosovës gjatë Korrik-Dhjetor vitit 2011. Këto të dhëna e determinojnë edhe përkushtimin e planeve të punës dhe aktiviteteve të tyre për këtë periudhë të theksuar kohore.

Periudha janar – qershor 2012 në total rezulton me 261 takime të mbajtura nga komisionet parlamentare, ku prej tyre 243 kanë qenë takime të rregullta kurse 18 prej tyre kanë qenë dëgjime publike.

Komisioni me numrin më të madh të mbledhjeve edhe në këtë periudhë raportuese është Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor me 37 takime. Pas tij radhiten si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa me 25 takime të realizuara ndërsa Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me gjithsejtë 22 mbledhje të mbajtura.

Komisioni me më së paku mbledhje të mbajtura gjatë kësaj periudhe raportuese është Komisioni për Punë të Jashtme me vetëm 9 takime të mbajtura

Muaji Maj dhe mars kanë qenë muajt që Komisionet parlamentare kanë mbajtur më së shumti mbledhje nga 46 ndërsa muaji Qershor ka qenë muaji që janë organizuar vetëm 36 nga të gjitha mbledhjet e Komisioneve parlamentare për këtë muaj.

## Dëgjimet Publike

Në periudhën Janar-Qershor 2012, Komisionet parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë organizuar gjithsej 18 dëgjime publike apo 4 më pakë se sa janë mbajtur gjatë periudhës Korrik-Dhjetor të vitit të kaluar.

Edhe më tutje dëgjimet publike janë mënyra e vetme ku shoqëria civile, grupet e interesit dhe qytetarët ofrojnë kontributin në procesin ligjvënës dhe trajtimit të çështjeve të ndryshme dhe zbatueshmërinë e tyre në praktikë.

Me numër më të madh të organizimit të dëgjimeve publike prinë Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione me gjithsejtë 5 takime të mbajtura, pas tij vjen Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa nga 4 ndërsa Komisioni për legjislacion me 2 dëgjime publike. Me nga 1 dëgjim publik kanë rezultuar Komisioni për të Drejtat, Interesat e komuniteteve dhe Për Kthim si dhe Komisioni për Arsim,



Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale. 7 komisione tjera nuk e kanë mbajtur asnjë dëgjim publik

Deputetët duhet të jenë më aktiv jo vetëm mbajtjen e mbledhjeve apo edhe shqyrtimin e projektligjeve por ata duhet të angazhohen edhe në këtë drejtim, në organizimin e sa më shumë dëgjimeve publike në mënyrë që legjislacioni i Kosovës të jetë sa më cilësor dhe më lehtë i zbatueshëm.

Komisionet parlamentare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Total
Komisioni për Buxhet dhe Financa	3	4	5	5	5	3	25
Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	3	4	4	2	3	2	18
Komisioni për Legjislacion	3	3	5	5	3	2	21
Komisioni për Integritim Evropian	2	2	3	2	2	4	15
Komisioni për Punë të Jashtme	0	2	2	2	1	2	9
Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	3	3	3	3	4	2	18
Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	4	4	4	4	4	2	22
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	3	3	4	3	2	4	19
Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor	7	7	6	6	9	2	37
Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës	4	4	4	2	2	3	21
Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë	1	2	2	2	2	2	11
Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	2	2	2	1	4	3	14
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	2	2	4	2	3	4	17
Komisioni për amendamentimin e ligjit për zgjedhjet	2	2	3	1	2	4	14

Tab. Numri i mbledhjeve të hapura të Komisioneve parlamentare gjatë periudhës janar-qershor 2012

## Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Komisionet Parlamentare të Kuvendit të Kosovës në kuadër të kompetencave që i kanë të përcaktuara me Rregulloren e Kuvenditjanë të obliguara që të monitorojnë zbatimin e ligjeve që dalin nga fushëveprimtaria e tyre. Fatkeqësisht angazhimi i tyre në këtë aspekt është shumë i mangët.

Nga dymbëdhjetë(12) komisionet parlamentare që i monitoron KDI, vetëm dy komisione kanë përfunduar procesin e monitorimit të zbatimit të ligjeve që i kanë të përcaktuar në planin e veprimit të tyre. Këto komisione janë : Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që ka përfunduar monitorimin e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës , ligj ky që ka filluar të monitorohet në fund të vitit 2011 dhe është miratuar raporti i punës së këtij monitorimi në shkurt të vitit 2012. Komisioni tjetër që ka përfunduar monitorimin e zbatimit të ligjeve për këtë sesion pranveror është komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Raportet e monitorimit të zbatimit të ligjeve për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe ligjit për mbrojtjen e konkurrencës janë miratuar edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës.

Komisionet që janë në proces të monitorimit të zbatimit të ligjeve janë: 1. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Punë të Jashtme, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrjen e Sigurisë, Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, Komisioni për Bujgësi, Pylltari, dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor dhe Komisioni për Integritet Evropian. Përkundër që në Planin e veprimit të Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është paraparë që të monitorohen zbatimi i ligjeve të fushave përkatëse, një proces i tillë as që ka filluar.

Ligjet që ka paraparë Kuvendi që të monitorohen në implementimin e tyre janë gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) e që vetëm tri (3) prej tyre janë monitoruar, çka tregon se Kuvendi nuk po e përmbush Planin e Veprimit të tij. Mbetet të shihet që në sesionin vjeshtor sa do të kenë progres në monitorimin e zbatimit të ligjeve të cilat kanë mbet të monitorohen, duke marrë parasysh angazhimin e dobët të komisioneve në këtë segment.

Komisionet Parlamentare duhet te angazhohen që të monitorojnë sa më shumë ligje në mënyrë që të sigurojnë se ligjet të cilat kanë kaluar në Kuvend po implemtohen në praktikë nga Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera përgjegjëse.


## ➤ Plani Legjislativ për vitin 2012

Kuvendi i Kosovës, me Programin e vet të punës për vitin 2012, ka paraparë miratimin e më se 122 projektligjeve dhe akteve të tjera. Shumë nga këto projektligje janë të bartura nga vitet paraprake të cilat janë planifikuar dhe nuk janë miratuar apo edhe të tilla të cilat e kanë kaluar leximin e parë, mirëpo nuk kanë arritur të miratohen me kohë edhe në leximin e dytë.

Në këtë periudhë raportuese Kuvendi ka miratuar 32 projektligje në të dy leximet, nga të cilat 17 janë të bartura nga viti paraprak. Në anën tjetër 10 projektligje janë miratuar në leximin e parë dhe mbesin në procedurë për miratim edhe në leximin e dytë.

Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk po mëson nga gabimet e veta dhe vit pas viti përsërit të njëjtin gabim duke planifikuar shumë dhe realizuar pak.

Sponsorimi i projektligjeve, në tërësi është planifikuar të bëhet nga Qeveria e Kosovës, dhe në këtë plan nuk janë paraparë shqyrtimet e raporteve të agjencive të pavarura veç e veç, duke bërë që këto shqyrtime të bëhen ad-hoc, duke mos patur një orar dhe dinamikë se deri kur, cili raport duhet të përmbillet së shqyrtuari, gjë e cila përcaktohet me ligjet themeltare të këtyre agjencive.




**Tab. 2 Numri i ligjeve të miratuara në periudhën janar-qershor 2012**

Përgjegjësia më e madhe i bie Qeverisë së Kosovës për mos procedim me kohë të të gjitha projektligjeve të cilat i ka planifikuar me strategjinë e vet legjislative, mirëpo Kuvendi asnjëherë nuk ka kërkuar përgjegjësi institucionale nga Qeveria për mos procedimin me kohë të të gjitha projektligjeve ashtu siç është paraparë në projeksionet fillestare.

Po ashtu edhe Kuvendi i Kosovës nuk mund të amnistohet nga përgjegjësia sepse ky institucion do duhej ti njihnte kapacitetet e veta dhe të trupave profesionale për të shqyrtuar legjislacionin. Kuvendi do të ishte mirë që të mos fokusohet kryekëput në aprovim mekanik të legjislacionit, pasi që kjo përcjell në vete mangësi në procesin e shqyrtimit dhe veçanërisht konsultimeve publike. Andaj edhe dëgjimet publike mbahen sa për sy e faqe dhe asnjëherë nuk ka proces të mirëfilltë të konsultimit të palëve të interesuara, ndoshta edhe duke dalur në terren vetë anëtarët e Kuvendit.

Kjo nxjerrë si konkluzion nevojën imperative për një kordinim më të madh të pushteteve në Kosovë për planifikim të nevojave dhe kapaciteteve për plotësimin e kornizës ligjore në Kosovë.



Tab 3. Paraqitja në përqindje e realizimit të Planit Legjislativ

## Analiza Krahasuese e Deputetëve

### Deputetët më aktiv

1. Ardian Gjini	3.57 %
2. Visar Ymeri	3.37 %
3. Hydajet Hyseni	3.35 %
4. Alma Lama	2.96 %
5. Sabri Hamiti	2.84 %
6. Myzejene Selmani	2.63 %
7. Safete Hadërgjonaj	2.57 %
8. Shaip Muja	2.57 %
9. Armend Zemaj	2.35 %
10. Ismet Beqiri	2.24 %

### Deputetët më pasiv

1. Justina Pula	-0.37 %
2. Fatmir Limaj	-0.31 %
3. Azem Syla	-0.18 %
4. Petar Miletqi	-0.18 %
5. Vesimir Savic	-0.12 %
6. Ukë Rugova	-0.10 %
7. Sreten Ivanoviq	-0.10 %
8. Anton Quni	-0.08 %
9. Etem Arifi	-0.08 %
10. Sasha Dokiç	-0.08 %

## REZULTATET E NOTIMEVE PËR SUBJEKTET POLITIKE

34	PDK	690	364	300	9	114	0	0	55	-120	28.83%
27	LDK	656	304	340	0	0	0	0	100	-94	26.67%
12	LVV	230	214	125	0	9	0	8	140	-64	13.36%
12	AAK	212	206	155	0	0	0	0	110	-45	13.03%
11	SLS	48	94	20	0	0	0	0	10	-37	2.76%
9	KKR	156	186	80	0	3	0	0	0	-20	8.27%
6	6+	36	126	35	0	0	0	0	0	-27	3.47%
9	Pa grup	144	0	60	0	0	0	0	10	-37	3.61%

Tabela gjenerale

Kuvendi i Kosoves		Pjesemarije ne diskutim	Diskutim ne emer te gr. apo Komisionit	Ceshtje apo propozime	Ceshtje urgjente	Propozim amendamente	Nisma Ligjore	Kerkesa per Interpelance	Pyetje parlamentare	Mungesa ne seance	pergjithshem	Notimi ne %
Deputet	Subjekti	4 pikë	2 pikë	5 pikë	9 pikë	3 pikë	10 pikë	8 pikë	5 pikë	1 - pikë		
1	PDK	ADEM GRABOVCI	4	46	25	9	0	0	0	0		1.72%
2		ARSIM BAJRAMI	48	14	20	0	0	0	0	0	-4	1.59%
3		AZEM SYLA	0	0	0	0	0	0	0	0	-9	-0.18%
4		BEHAR SELIMI	16	14	5	0	0	0	0	0	-3	0.65%
5		BEKIM HAXHIU	28	2	10	0	15	0	0	0	-2	1.08%
6		BERAT BUZHALA	16	4	0	0	0	0	0	0	-9	0.22%
7		BLERTA DELIU-KODRA	12	10	10	0	0	0	0	15	-1	0.94%
8		ELMI REÇICA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
9		FADIL DEMAKU	24	0	10	0	0	0	0	0	-2	0.65%
10		FATMIR LIMAJ	0	0	0	0	0	0	0	0	-15	-0.31%
11		FATMIR XHELILI	12	6	5	0	0	0	0	0	-1	0.45%
12		FLORA BROVINA	12	4	5	0	0	0	0	0	-5	0.33%
13		GANIMETE MUSLIU	68	2	30	0	0	0	0	5	-1	2.12%
14		HALIT KRASNIQI	60	2	20	0	0	0	0	0	-3	1.61%
15		HASIME KRASNIQI	8	16	0	0	0	0	0	0	0	0.49%
16		HYDAJET HYSENI	68	4	40	0	48	0	0	0	-1	3.25%
17		IDRIZ VEHAJI	4	32	10	0	0	0	0	0	-2	0.90%
18		JAKUP KRASNIQI	24	0	5	0	0	0	0	0	-4	0.51%
19		JUSTINA PULA	0	0	0	0	0	0	0	0	-18	-0.37%
20		KURTAN KAJTAZI	8	6	5	0	0	0	0	0	-2	0.35%
21		LATIF GASHI	12	6	10	0	0	0	0	0	0	0.57%
22		LUMNIJE MORINA	8	0	0	0	0	0	0	5	0	0.27%
23		NAHIT HASANI	8	22	5	0	6	0	0	0	-4	0.76%
24		NIJAZI IDRIZI	20	6	20	0	0	0	0	0	-1	0.92%
25		RAMË VATAJ	8	0	0	0	0	0	0	0	-8	0.00%
26		RAMIZ LLADROVCI	12	2	0	0	0	0	0	5	-1	0.37%
27		SAFETE HADERGJONAJ	16	96	10	0	6	0	0	0	-2	2.57%
28		SALA BERISHA - SHALA	32	16	0	0	0	0	0	5	-2	1.04%
29		SALIHE MUSTAFA	22	4	10	0	0	0	0	5	0	0.84%
30		SHAIP MUJA	68	4	20	0	39	0	0	0	-5	2.57%
31		VALBONA DIBRA	20	0	0	0	0	0	0	10	-3	0.55%
32		XHAVIT HALITI	12	0	10	0	0	0	0	0	-9	0.27%
33		XHEVAHIRE IZMAKU	24	6	5	0	0	0	0	5	0	0.82%
34		ZENUN PAJAZITI	16	40	10	0	0	0	0	0	-3	1.29%

35	LDK	AFERDITA BERISHA – SHAQIRI	12	0	5	0	0	0	0	10	-2	0.51%	
36		ALI SADRIU	28	10	10	0	0	0	0	0	-1	0.96%	
37		ANTON QUNI	0	6	0	0	0	0	0	0	-10	-0.08%	
38		ARBEN GASHI	44	46	5	0	0	0	0	0	-3	1.88%	
39		ARMEND ZEMAJ	72	20	25	0	0	0	0	0	-2	2.35%	
40		BAHRI THAÇI	4	2	5	0	0	0	0	0	-3	0.16%	
41		EQREM KRYEZIU	8	2	10	0	0	0	0	0	-4	0.33%	
42		HAKI DEMOLLI	36	8	25	0	0	0	0	0	-6	1.29%	
43		HASHIM DESHISHKU	44	8	35	0	0	0	0	0	-4	1.69%	
44		HYKMETE BAJRAMI	20	14	0	0	0	0	0	10	-5	0.80%	
45		IMRI AHMETI	8	0	5	0	0	0	0	0	-5	0.16%	
46		ISMET BEQIRI	12	80	20	0	0	0	0	0	-2	2.25%	
47		LIRIJE KAJTAZI	16	2	5	0	0	0	0	0	-3	0.41%	
48		LUTFI HAZIRI	32	8	5	0	0	0	0	5	-10	0.82%	
49		LUTFI ZHARKU	4	12	25	0	0	0	0	0	-3	0.78%	
50		NASER OSMANI	0	10	0	0	0	0	0	0	-9	0.02%	
51		NAZANE BRECA	16	8	0	0	0	0	0	35	0	1.20%	
52		KIMETE BYTYCI	16	0	5	0	0	0	0	35	-1	1.12%	
53		RITA HAJZERAJ – BEQAJ	28	12	25	0	0	0	0	5	0	1.43%	
54		SABRI HAMITI	100	2	40	0	0	0	0	0	-3	2.84%	
55		SADRI FERATI	12	2	10	0	0	0	0	0	0	0.49%	
56		SALI ASLLANAJ	16	4	10	0	0	0	0	0	-2	0.57%	
57		SALIH MORINA	28	12	10	0	0	0	0	0	-3	0.96%	
58		SKENDER HYSENI	8	0	5	0	0	0	0	0	-7	0.12%	
59		TEUTA SAHATQIJA	36	22	15	0	0	0	0	0	-2	1.45%	
60		VJOLLCA KRASNIQI	20	6	15	0	0	0	0	0	-1	0.82%	
61		VJOSA OSMANI	36	8	25	0	0	0	0	0	-3	1.35%	
62		Vetevendosje	AFRIM HOTI	16	0	5	0	0	0	0	0	-3	0.37%
63			ALBANA FETOSHI	4	12	5	0	0	0	0	0	-2	0.39%
64			ALBANA GASHI	28	6	15	0	0	0	0	5	-2	1.06%
65			ALBIN KURTI	20	4	10	0	0	0	0	0	-11	0.47%
66			ALBULENA HAXHIU	26	28	5	0	3	0	0	25	-3	1.72%
67			ALMA LAMA	52	18	20	0	6	0	0	55	-6	2.96%
68			AFRIM KASOLLI	16	8	5	0	0	0	0	10	-3	0.74%
69			FLORIN KRASNIQI	4	0	5	0	0	0	0	0	-11	-0.04%
70			GLAUK KONJUFCA	16	2	10	0	0	0	0	10	-8	0.61%
71			LIBURN ALIU	4	24	20	0	0	0	0	10	-7	1.04%
72			REXHEP SELIMI	16	12	5	0	0	0	0	5	-5	0.67%
73			VISAR YMERI	28	100	20	0	0	0	0	20	-3	3.37%
74			AAK	AHMET ISUFI	16	20	5	0	0	0	0	-5	0.74%
75				ARDIAN GJINI	44	90	45	0	0	0	0	0	-4
76		BALI MUHAREMAJ		0	0	0	0	0	0	0	0	-2	-0.04%

77		BLERIM SHALA	8	2	10	0	0	0	0	0	-2	0.37%
78		BURIM RAMADANI	12	18	10	0	0	0	0	10	-3	0.96%
79		DAUT HARADINAJ	20	0	5	0	0	0	0	5	-10	0.41%
80		DONIKA KADAJ – BUJUPI	20	12	20	0	0	0	0	30	-6	1.55%
81		KYMETE BAJRAKTARI	12	12	20	0	0	0	0	0	0	0.90%
82		RAMIZ KELMENDI	8	0	10	0	0	0	0	5	-10	0.27%
83		TEUTA HAXHIU	48	8	25	0	0	0	0	10	-1	1.84%
84		XHEVDET NEZIRAJ	4	32	0	0	0	0	0	10	-2	0.90%
85		TIME KADRIJAJ	20	12	5	0	0	0	0	40	0	1.57%
86		MILIVOJE STOJANOVIC	0	4	0	0	0	0	0	0	-2	0.04%
87		JELENA BONTIC	4	12	0	0	0	0	0	0	-1	0.31%
88		PETAR MILETIC	0	2	0	0	0	0	0	0	-11	-0.18%
89		JASMINA ZIVKOVIC	4	6	5	0	0	0	0	0	-1	0.29%
90		SASA MILOSAVLJEVIC	4	32	0	0	0	0	0	0	-2	0.69%
91		BISERKA KOSTIC	4	22	5	0	0	0	0	0	-1	0.61%
92		ETEM ATIFI	0	0	0	0	0	0	0	0	-4	-0.08%
93		SASA ĐOKIC	0	0	0	0	0	0	0	0	-4	-0.08%
94		GORAN MARINKOVIC	28	6	5	0	0	0	0	10	-2	0.96%
95		BOBAN TODOROVIC	0	2	0	0	0	0	0	0	-3	-0.02%
96		MURSELJ HALJILJI	4	8	5	0	0	0	0	0	-6	0.22%
97		AMIR AHMETI	4	2	0	0	0	0	0	0	-4	0.04%
98		GEZIM KELMENDI	32	4	10	0	0	0	0	0	-1	0.92%
99		EMIN GERBESHI	20	0	15	0	0	0	0	0	0	0.71%
100		JETON SVIRCA	16	8	0	0	0	0	0	0	-2	0.45%
101		MUHAMET MUSTAFA	40	20	30	0	3	0	0	0	0	1.90%
102		MYZEJENE SELMANI	12	110	10	0	0	0	0	0	-3	2.63%
103		SEVDIJE LAMA	12	6	5	0	0	0	0	0	-1	0.45%
104		SUZAN NOVOBRDALIU	20	36	10	0	0	0	0	0	-4	1.27%
105		UKË RUGOVA	0	0	0	0	0	0	0	0	-5	-0.10%
106		RASIM DEMIRI	8	6	5	0	0	0	0	0	-3	0.33%
107		ENIS KERVAN	4	2	5	0	0	0	0	0	-7	0.08%
108		DUDA BALJE	8	36	10	0	0	0	0	0	-4	1.02%
109		ALBERT KINOLLI	4	48	5	0	0	0	0	0	-2	1.12%
110		MUFERA SINIK	0	14	0	0	0	0	0	0	-8	0.12%
111		FIKRIM DAMKA	12	20	10	0	0	0	0	0	-3	0.80%
112		AURORA BAKALLI	36	0	15	0	0	0	0	10	-3	1.18%
113		AGIM KULETA	40	0	10	0	0	0	0	0	0	1.02%
114		HAMZA BALJE	8	0	5	0	0	0	0	0	0	0.27%
115		VESIMIR SAVIC	0	0	0	0	0	0	0	0	-6	-0.12%
116		VESNA MIKIC	12	0	5	0	0	0	0	0	-6	0.22%
117		EMILLIJA REDZEPI	36	0	15	0	0	0	0	0	-2	1.00%
118		RADA TRAJKOVIC	8	0	5	0	0	0	0	0	-14	-0.02%



119		SRETEN IVANOVIC	0	0	0	0	0	0	0	0	0	-5	-0.10%
120		DANUSH ADEMI	4	0	5	0	0	0	0	0	0	-1	0.16%
			217	149	111								100.00
			2	4	5	9	126	0	0	425	-444		%

“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit Demokratik të Kosovës KDI, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.